REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT ZHVILLIMIT TË TOKËS
SEKTORI I KADASTRËS DHE INVENTARIZIMIT TË ASETEVE

PROJEKT –VENDIM

Nr. 50 **Datë** 22 . 06. **2026**

"PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 48 DATË 31.07.2023 "PËR MIRATIMIN E SHTESËS NË INVENTARIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË KËRKOHET TË KALOHEN NË PRONËSI TË BASHKISË DEVOLL TË PASURIVE KADASTRALE ME NUMËR: 697, NR.700 ZK. 1202 FSHATI BITINCKË".

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" neni 37, 39 Ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën". dhe shkresës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria e Pronave Shtetërore me Nr. 311/1 prot. datë 16.6.2026 "Mbi kthimin e projektvendimit për transferimin e pasurive në Bashkinë Devoll".

PROPOZOJ:

1-Pas pikës 2 të VKB-së Nr. 48 datë 31.07.2023 të shtohet pika 2.1 me përmbajtje si më poshtë:

2.1-Pasuritë në proces inventarizimi me: nr.697, nr.700 ZK. 1202 fshati Bitinckë sipas VKB-së nr. 48 datë 23.07.2023 do të përdoren për realizimin e funksioneve dhe/ose shërbimeve, të njohura të ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar neni 3, pika ç) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike, pika k) Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi.

3-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kadastrës dhe Inventarizit të Aseteve .

4-Ky projekt-vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

Eduard Duro

Hartoi Përgjegjës i Sektorit: E. Rado

Konfirmoi bazueshmërinë ligjore: E. Avdo

Miratoi:Sekretar i Përgjithshëm A. Rushitaj

Bashkia Devoll, Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, E-mail bashkiadevoll@gmail.com.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT ZHVILLIMIT TË TOKËS
SEKTORI I KADASTRËS DHE INVENTARIZIMIT TË ASETEVE

Nr.2395 prot. **Bilisht, më 22.06.2026**

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

"PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 48 DATË 31.07.2023 "PËR MIRATIMIN E SHTESËS NË INVENTARIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË KËRKOHET TË KALOHEN NË PRONËSI TË BASHKISË DEVOLL TË PASURIVE KADASTRALE ME NUMËR: 697, NR.700 ZK. 1202 FSHATI BITINCKË".

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Devoll!

Pranë Bashkisë Devoll është drejtar shkresa e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria e Pronave Shtetërore me Nr. 311/1 prot. datë 16.6.2026 "Mbi kthimin e projektvendimit për transferimin e pasurive në Bashkinë Devoll" me arsyetimin që në vendimin nr. 48 datë 31.07.2023 nuk është përcaktuar qartë dhe në menyrë shteruese destinacioni i përdorimit për pasuritë nr. 697, nr. 700 ZK. 1202 fshati Bitinckë që kërkohen të transferohen në pronësi të Bashkisë Devoll, sipas ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar,

Drejtorinë e Pronave Shtetërore si institucion i ngarkuar me ligj për ndjekjen kordinimin dhe përfundimin e procedurave lidhur me procesin e inventarizimit të pronave të paluajtshme të shtetit, përditësimin e inventareve të pronave të paluajtshme të pushtetit qëndror dhe atyre të transferuara njësive të vetëqeverisjes vendore me VKM-në Nr. 202 datë 13.03.2013 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Qendër Bilisht të Qarkut të Korçës" po vijon me kryerjen e procesit të inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore në

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm.
Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njesitë e qeverisjes vendore".

Udhëzimit nr. 15 datë 30.06.2003 "Për mënyren e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", në zbatim të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" neni 37, 39 ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën",

Drejtoria e Pronave Shtretërore është Institucioni përgjegjës që udhëheq procesin e inventarizimit dhe transferimit të pronave publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Pasuritë me numër: 697, nr. 700 ZK. 1202 fshati Bitinckë sipas vendimit do të inventarizohen dhe të përdoren për realizimin e funksioneve dhe/ose shërbimeve për bashkësinë të njohura të ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar neni 3 pika ç) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike, pika k) Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi nga Bashkia Devoll.

Procesi i inventarizimit ndihmon në krijimin e një pasqyre të qartë të pronave në administrim të Bashkisë Devoll duke mundësuar menaxhimin sa më të mirë dhe transparent të pasurive publike.

Vendodhja e pasurive paraqet kushte të favorshme natyrore dhe këto prona mund të shfrytëzohen nga persona fizikë dhe juridikë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike dhe shërbimeve në përputhje me destinacionin e tyre,

Kjo do të sjellë ritjen e të ardhura vendore të konsiderushme, të ardhura të cilat do të përdoren për përmirësimin e kushteve të komunitet në territorin e Bashkisë Devoll.

Dhënia me qira e këtyre pronave do të realizohet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak duke përcaktuar kushtet afatet dhe vlerën e qirasë për secilën pronë.

Bashkia Devoll, Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, E-mail bashkiadevoll@gmail.com.

Për sa më sipër kërkojmë miratimin e projekt vendimit per pasurite 697, nr. 700 ZK. 1202 fshati Bitinckë sipas vendimit do të inventarizohen dhe të përdoren për realizimin e funksioneve dhe/ose shërbimeve për bashkësinë të njohura të ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar neni 3 pika ç) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike, pika k) Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi nga Bashkia Devoll.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi : Specialist M. Agolli

Specialist: M. Hanelli

Pranoi: Përgjegjës i Sektorit: E. Rado

Bashkia Devoll, Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, E-mail bashkiadevoll@gmail.com.

18.06.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA E PRONAVE SHTETËRORE

Nr. 311/1 Prot.

Tiranë, më 16. 06.2026

Lënda: Mbi kthimin e projektvendimit për transferimin e pasurive në Bashkinë Devoll

BASHKISË DEVOLL

Në vijim të kërkesës suaj nr. 2992/2 prot., datë 12.11.2024, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka paraqitur pranë Kryeministrit projektvendimin me titull: "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Devoll të disa pasurive me vendndodhje në njësinë administrative Qendër Bilisht, si dhe për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 764, datë 7.11.2012, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Bilisht, Bashkia Devoll, Qarku Korçë', të ndryshuar".

Bazuar në shkresën nr. 446/3611 prot., datë 05.06.2026, të Kryeministrisë, ju vëmë në dijeni për kthimin e projektaktit, me argumentin se në vendimet e Këshillit Bashkiak, bashkëlidhur praktikës shoqëruese, nuk është përcaktuar qartë dhe në mënyrë shteruese destinacioni i përdorimit për 11 pasuritë që kërkohen të transferohen në pronësi të Bashkisë Devoll.

Ky përcaktim është i domosdoshëm për realizimin e funksioneve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Bashkëlidhur gjeni shkresën e Kryeministrisë nr.446 prot., datë 05.06.2026, si dhe dokumentacionin shoqërues.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTOR

Edmir NUFI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS DREJTORIA E PRONAVE SHTETËRORE

311
15.06.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA JURIDIKE DHE E KONTROLLIT TEKNIKO-LIGJOR

Nr. 7073/1 Prot.

Tiranë, më 15.06.2026

Lënda: Përcillet shkresë nr. 446/3611 prot., datë 05.06.2026

DREJTORISË SË PRONAVE SHTETËRORE
Adresa: Rr "Qamil Guranjaku", Tiranë

Në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së është administruar me nr. 7073 prot., datë 09.06.2026, shkresa nr. 446/3611 prot., datë 05.06.2026, e Kryeministrisë, me anë të së cilës, kthehet projektvendimi, dërguar nga ana juaj me shkresën nr. 23 prot., datë 15.1.2025, me arsyetimin se nuk është përcaktuar qartë dhe në mënyrë shteruese nga ana e Bashkisë Devoll, destinacioni i përdorimit të 11 pasurive që kërkohen të transferohen në pronësi të kësaj bashkie, në vendimet e Këshillit Bashkiak bashkëlidhur praktikës shoqëruese.

Sa më sipër, për njohje nga ana juaj.

Bashkëlidhur, gjeni shkresën e Kryeministrisë nr. 446/3611 prot., datë 05.06.2026 dhe dokumentacionin shoqërues.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Lorena GJONHOBELLI

AGJENCIA ... DPT. ... Nr. 2043 Prot. Tiranë, më 05.06.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

1

Nr. 446 -> 2025 prot. / 3611

Tiranë, më 05.06. 2026

Lënda: Kthim projektvendimi

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr.778/1 prot., datë 20.1.2025, me lëndë "Dërgohet projektvendim", nëpërmjet së cilës është dërguar projektvendimi "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Devoll të disa pasurive me vendndodhje në Njësinë Administrative Qendër Bilisht dhe për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.764, datë 7.11.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative Bilisht, Bashkia Devoll, të Qarkut të Korçës", të ndryshuar", ju kthejmë projektvendimin pasi nuk është përcaktuar qartë dhe në mënyrë shteruese destinacioni i përdorimit të 11 pasurive që kërkohen të transferohen në pronësi të Bashkisë Devoll në vendimet e këshillit bashkiak bashkëlidhur praktikës shoqëruese, për realizimin e funksioneve të veta në përputhje me parashikimet e ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar dhe ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Elsonida RAMO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE - SEKRETARIATI

KËSHILLI I MINISTRAVE
Nr. 446 Prot.
Data 22.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 778/1 Prot.

Tiranë më 21.01.2025

Lënda: Dërgohet projektvendim.

KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Z. ËNGJËLL AGAÇI
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Adresa: "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

I nderuar,

Në zbatim të pikës 2, të nenit 9 të Ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" dhe Kreut IV të Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim e miratim:

- Projektvendimin, "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Devoll të disa pasurive me vendndodhje në Njësinë Administrative Qendër Bilisht dhe për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.764, datë 7.11.2012 të Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative Bilisht, Bashkia Devoll, të Qarkut të Korçës", të ndryshuar", së bashku me relacionin përkatës.

Draftin e projektaktit, së bashku me relacionin shpjegues, e gjeni në format shkresor dhe në CD.

Me respekt!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lorena GOXHOBELLI

Adresa: Rr. "Dora D'Istria", Tiranë, Tel/fax. +355/4/449406

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA E PRONAVE SHTETËRORE

Nr 23 Prot.

Tiranë, më 15.01.2025

Lënda: Dërgohet projektvendim

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
ZNJ. LORENA GOXHOBELLI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
TIRANË

E nderuar znj. Drejtoreshë e Përgjithshme,

Bashkëlidhur ju dërgojmë projektvendimin "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Devoll të disa pasurive me vendndodhje në njësinë administrative Qendër Bilisht dhe për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.764, datë 7.11.2012, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Bilisht, Bashkia Devoll, të Qarkut të Korçës" të ndryshuar", së bashku me relacionin përkatës.

Draftin e projektaktit, së bashku me relacionin shpjegues, e gjeni në format shkresor dhe në CD.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTOR
Edmir NUFI

Adresa: Rr. "Dora D'Istria", Tiranë, Tel/fax. +355/4/449406

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë___.___.2025

PËR

TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DEVOLL TË DISA PASURIVE ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDËR BILISHT DHE PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.764, DATË 7.11.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE BILISHT, BASHKIA DEVOLL TË QARKUT TË KORÇËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "ç", 5 dhe 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 764, datë 7.11.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative Bilisht, Bashkia Devoll të Qarkut të Korçës", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1) Kudo në titull dhe në përmbajtje të vendimit, hiqet togfjalëshi "Njësia Administrative Bilisht".

2) Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"Transferimin në pronësi të Bashkisë Devoll, të disa të pasurive me vendndodhje në Njësinë Administrative Qendër Bilisht, sipas formularëve gjithsej 3 (tre) fletë dhe planeve të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik."

3) Pas pikës 1.1, shtohet pika 1.2, me këtë përmbajtje:

"Pasuritë e përcaktuara në pikën 1.1, të këtij vendimi, me numër rendor 387-397, i shtohen listës së inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr.764, datë 7.11.2012, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Devoll, të Qarkut të Korçës" të ndryshuar."

4) Pas pikës 1.2, shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

"Bashkisë Devoll i ndalohet ta tjetërsojë ose të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurive së përcaktuara në pikën 1.1, të këtij vendimi."

II. Ngarkohen Bashkia Devoll dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KESHILLI I BASHKISE DEVOLL

VENDIM

Nr. 48 . Date 31/07/2023

Për miratimin e shtesës me inventarin e pronave te paluajtshme shtetërore që kerkohet te kalohen në pronesi të Bashkisë Devoll të pasurive: nr.697,nr.700 ZK1202 fshati Bitinckë

Në mbeshtetje te ligjit nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjën Vendore", ligjit nr.8743, date 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme te shtetit", i ndryshuar, ligjit nr. 8744, date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave te paluajshme publike te shtetit ne njesitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, ne zbatim te ligjit nr.20/2020 "Per perfundimin e proceseve kalimtare te pronesise ne Republiken e Shqiperise" neni 37,39 ligjit nr. 111/2018 "Per Kadastren"

Keshilli I Bashkise Devoll me 14 vota pro, 0 kunder dhe 0 abstenim :

VENDOSI:

1-Te miratohet shtesa në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen të kalohen në pronësi të Bashkisë Devoll.

2-Pasurite që do të inventarizohen janë: nr.697, nr.700 ZK 1202 fshati Bitinckë

3-Të miratohet dërgimi i shtesës së inventarit për shqyrtim në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

4-Ky projekt-vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore"

KRYETARI I KESHILLIT

GENTI LAKOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Nentori, Nr. 9, Tel/Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com